



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 360

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE,  
BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Sot, më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me,

**OBJEKT:** Miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

**BAZË LIGJORE:** Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr. 8, datë 23.2.2023, i Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

VËREJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 290, datë 5.4.2023, ka regjistruar z. Erion Veliaj si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 291, datë 5.4.2023, ka regjistruar z. Belind Këlliçi si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Data: 15.4.2023 Nr: 360  
Ora: 10:30



“Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 292, datë 5.4.2023, ka regjistruar z. Roland Bejko, si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 293, datë 5.4.2023, ka regjistruar z. Arlind Qori, si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 294, datë 5.4.2023, ka regjistruar z. Marko Dajti, si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Fronti Majtë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 295, datë 5.4.2023, ka regjistruar znj. Lajla Pernaska, si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Në përfundim të procesit të hedhjes së shortit të kandidatëve për Kryetar për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, KQZ, në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbledhjen e datës 13.4.2023, KQZ organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar,

Në përfundim të zhvillimit të shortit rezultoi se, z. Arlind Qori renditet i pari, z. Marko Dajti renditet i dyti, znj. Lajla Pernaska renditet e treta, z. Erion Veliaj renditet i katërti, z. Belind Këlliçi i pesti, z. Roland Bejko i gjashti.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 98, pika 3, 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar,

### **VENDOS:**

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





# FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për Organet  
e Qeverisjes Vendore  
14 maj 2023

QARKU Tiranë  
BASHKIA Tiranë

ZAZ Nr.  
QVNr.

## KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE

shënimi i votuesit

1	 <b>ARLIND MUHAMET QORI</b> LËVIZJA BASHKË	BASHKË	
2	 <b>MARKO SALI DAJTI</b> FRONTI I MAJTË	FM	
3	 <b>LAJLA YLBER PERNASKA</b> PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET	PDIU	
4	 <b>ERION LUAN VELIAJ</b> PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	PS	
5	 <b>BELIND ZAMIR KËLLIÇI</b> BASHKË FITOJMË	BF	
6	 <b>ROLAND HYSEN BEJKO</b> PARTIA DEMOKRATIKE	PD	



SPECIMEN 3.1